

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË PRRENJAS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Prenjas me objekt: Vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, etj” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 102, datë 30.6.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 417/7, datë 30.6.2012, dërguar z. **Bajazit KARRIQI**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të merren masa nga Bashkia, që të dërgohen pranë Ministrisë së Financave përgjigjeje të pyetësorit si dhe shtojcat nr. 1 e nr. 2, që trajtojnë plotësimin e dy deklaratave e respektivisht: “*Deklaratë për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë për vitin 2011*” si dhe “*Raportin për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë për vitin 2011*”, deklarata të cilat nënshkruhen nga nëpunësi autorizues. Në këtë kuadër Bashkia duhet të bëjë vlerësimin e përgjithshëm për periudhën janar-dhjetor 2011, konform ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe UMF nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor, për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”.

Menjëherë

2. Të merren masa, që të bëhet vetëvlerësimi për menaxhimin financiar dhe kontrollin, gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm, sipas komponentëve, duke paraqitur: mjedisin e kontrollit, aktivitetet e kontrollit, monitorimin etj. Në mjedisin e kontrollit të përcaktohen faktorët, si: integriteti, vlerat etike, dhe profesionalizmin e punonjësve të njësisë, filozofinë dhe stilin e punës së titullarit, mënyrën se si drejtuesi shpërndan detyrat dhe ngarkon përgjegjësitë apo si organizon punonjësit në njësi, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep bordi i menaxherëve.

Menjëherë

3. Të merren masa, që formatet e bilanceve duhet të plotësohen konformë UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për paraqitjen e raportimit të pasqyrave financiare vjetore për vitin 2006, me ndryshimet, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre”, duke pasur parasysh edhe rakordimet në fund vitit me Degën e Thesarit, të trajtuara në mënyrë të hollësishme në kapitullin e bilancit.

Vazhdimisht

4. Në mbështetje të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, të operohet me ditarin centralizator (libri i madh), duke pasqyruar efektet e veprimeve ekonomike të klasifikuara sipas llogarive të prekura nga azhurnimi në ditarë, nëpërmjet mbartjes së shumave nga ditarët në fund të periudhës ushtrimore.

Vazhdimisht

5. Të merren masa për gjetjen e adresave dhe arkëtimet e debitorëve në maksimumin e mundshëm, e sidomos për ato pa shpresë arkëtimi të trajtuar në mënyrë analitike në kapitullin mbi debi kreditë.

Vazhdimisht

6. Në fletëdaljet e kontabilizimit të magazinave të bashkëlidhen vetëm dokumentet justifikues të harxhimit të ushqimeve dhe jo dokumentet personale që mbajnë drejtoria e kopshtit dhe e çerdhes.

Vazhdimisht

7. Të merren masa, që për furnizimin me ujë dhe ruajtje shkolle për Shkollën 9-vjeçare “1 Maj” Rashtan-Përrenjas (vartësi të Bashkisë Përrenjas), meqenëse ka vendim të Këshillit Bashkiak, me subjektin privat të hartohet kontratë e re, në të kundërtën të ndërpritet kryerja e pagesave.

Menjëherë

8. Pagesat e supervizorëve, të bëhen në mbështetje të kontratave të lidhura mes palëve, si dhe faturave tatimore të paraqitur nga supervizorët e të sigluar nga personi i autorizuar i bashkisë.

Vazhdimisht

9. Seksioni i Financës të mbajë regjistra të saktë e me përgjegjësi për blerjet e shërbimet me vlera të vogla, konformë legjislacionit në fuqi, për efekt kontrolli të mos kalimit të kufirit prej 480 mijë lekë së bashku me t.v.sh-në.

Vazhdimisht

10. Pagesat e fjetjeve në hotele të bëhen konformë VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”, pika III/3/b dhe pagesat e celularëve për punonjësit e bashkisë të bëhen konformë VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik, publik”.

Vazhdimisht

11. Të kërkohet në rrugë ligjore konstatimi si akt absolutisht i pa vlefshëm i Kontratës Shtesë të pastrimit të qytetit me firmën sipërmarrëse [REDAKTUAR] datë 01.02.2012, e lidhur në kundërshtim me dispozitat ligjore nga ish-kryetari i Bashkisë.

Menjëherë

12. Të merren masa, nga ana e Njësisë së Prokurimit të Autoritetit Kontraktor, për inventarizimin në mënyrë të rregullt të dosjeve të prokurimeve dhe arkivimin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Vazhdimisht

13. Nga ana e Bashkisë të merren masa për caktimin e kolaudatorit, me qëllim marrjen në dorëzim të objektit: “Shkolla 9 vjeçare Përrenjas”, deri në fazën e punimeve të kryera në këtë objekt nga sipërmarrësi.

Menjëherë

14. Me qëllim rritjen e të ardhurave të buxhetit, Bashkia Përrenjas të bashkërendojë punën me Komunën Rrajcë dhe të marri masat e duhura për përcaktimin e saktë të kufirit të territorit, me qëllim riaktivizimin e biznesit të vogël.

Menjëherë

15. Nga Bashkia Përrenjas të merren masa, për arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga taksa e tokës, si dhe për arkëtimin e debitorëve të trashëguar prej vitesh në shumën **792,328 lekë**.

Vazhdimisht

16. Nga Zyra e Urbanistikës dhe Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor, të merren masa, që nga subjektet ndërtuese, të kërkohet pagesa për detyrimin e papaguar të lejes së ndërtimit (1 për qind i vlerës së investimit për studime urbanistike dhe 2 për qind vlerës së investimit si taksë e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja), për 5 subjekte për vlerën prej **591,318 lekë**, të cilat kanë filluar punimet pa bërë pagesën dhe për rrjedhojë pa u pajisur me formularin nr. 4, si dhe të plotësohen me dokumentacionin e duhur tekniko ligjor të gjitha dosjet për të cilat është miratuar leja e ndërtimit.

Menjëherë

17. Nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor, në bashkëpunim me Zyrën e Urbanistikës, të merren masat për evidentimin e ndërtimeve pa leje, duke aplikuar gjoba ndaj subjekteve ndërtuese të kundërligjshme, me qëllim mbajtjen nën kontroll administrimin dhe zhvillimin e territorit.

Vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për shpërblimin e dëmit me vlerë **3,409,549 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

a. Pagesat e kryera për bisedime telefonike me celularë për vlerën **435,305 lekë** për vitin 2010 dhe **425,587 lekë** për vitin 2011, pagesa të cilat janë bërë në kundërshtim me VKM nr. 343, datë 11.7.2002 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik, publike”, pika 2, si dhe VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik, publik”, për personat e cilësuar në urdhrat e Bashkisë nr. 3, datë 11.01.2010 për 14 punonjës; nr. 12, datë 05.5.2011 për 14 punonjës si dhe nr. 46/1, datë 30.9.2011 të protokolluar me nr. 428, datë 30.9.2011 për 22 punonjës.

b. Mos ndalim të tatimeve në burim për aktivitete të ndryshme të kryera nga kjo Njësi Publike, në vlerën prej **14,190 lekë** si më poshtë:

- Këngëtarëve për koncertin e 1 Qershorit në vlerën **2,750 lekë**.
- Subjektit privat Fruta Perime [REDAKTUAR] për koncertet në vlerën, **6,900 lekë**.
- Kryeplakut të fshatit [REDAKTUAR] si agjent tatimor në vlerën, **540 lekë**.
- Subjektit privat [REDAKTUAR] për marrje të objektit me qira si “thertore” nga Bashkia në vlerën **4,000 lekë**, të cilësuar në pikën nr. 4, kapitullin “Rregullariteti i veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës, në përputhje me disiplinën financiare” të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

c. Pagesa të hotelit për sportistët pa faturë të kasës fiskale në vlerën prej **81,000 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”, pika III/3/b.

Problemet e mësipërme janë trajtuar në mënyrë analitike në pikën nr. 4, kapitullin “Rregullariteti i veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës, në përputhje me disiplinën financiare” të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

ç. Pagesa prej **1,654,440 lekë**, të përfituara për punë të pa kryera nga firma sipërmarrëse [REDAKTUAR] në ndërtimin e shkollës 9-vjeçare Prrerjas.

d. Pagesa prej **355,657 lekë**, të rezultuara nga llogaritja gabim e kostos së ndërtimit, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit si më poshtë:

- z. [REDACTED] në vlerën prej 25,223 lekë;
- z. [REDACTED] në vlerën prej 45,799 lekë;
- z. [REDACTED] në vlerën prej 196,839 lekë;
- z. [REDACTED] në vlerën prej 63,699 lekë;
- z. [REDACTED] në vlerën prej 24,097 lekë.

e. Pagesa prej: **443,370 lekë**, të rezultuara nga mos pagesa e lejeve të shfrytëzimit dhe taksës për përgatitje dosje.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 25 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe pikën 1 e 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me shkrim”, neni 25, pika 3, germa a

1. Për z. [REDACTED] me detyrë kryeinspektor i INUV të Bashkisë, me motivimin:

Për mos aplikim gjobe për shkeljet e konstatuara në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës, në kundërshtim me, germën “b” të nenit 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar.

2. Për ish-punonjësit e mëposhtëm:

- z. [REDACTED] me detyrë ish-drejtor i Drejtorisë Juridike;
- znj. [REDACTED] me detyrë ish-inspektore e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor;
- z. [REDACTED] me detyrë ish Drejtor i Drejtorisë të Zhvillimit Urban;
- z. [REDACTED] me detyrë ish-specialist pranë Bashkisë Prrrenjas,
- z. [REDACTED] me detyrë ish supervizor;
- znj. [REDACTED] me detyrë ish Drejtore e Drejtorisë Ekonomike, nuk rekomandojmë masa disiplinore për shkak se kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Bashkinë dhe për pasojë nuk mund të jepen masa disiplinore ndaj tyre.

D. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 248 “Shpërdorim detyre”, të bëhet kallëzim penal ndaj ish-kryetarit të Bashkisë

- Për lidhje kontratë shtesë datë 01.2.2011, me firmën e pastrimit [REDACTED] me administrator z. [REDACTED], për një afat nga data 01.02.2011 deri në datë 31.12.2012, me vlerë prej **1,869,338 lekë**. Objekti i kësaj shtesë kontrate është: “Pastrimi i rrugëve shtesë të kësaj Bashkie dhe lagjen e tyre”.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Muhamed Kavaja, Milo Pano, Ymer Stafa dhe Xhemal Luka. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT